



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

---

Numri i lëndës: 2023:099536  
Datë: 17.05.2024  
Numri i dokumentit: 05699369

Ac.nr.7439/2023

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, kolegji në përbërje nga gjyqtari Ardian Ajvazi – kryetar i kolegjit dhe gjyqtarëve Nehat Idrizi e Naim Mehulli – anëtar të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditësit A.....N..... nga fshati Elezaj rr. "Çamëria" Komuna Kaçanik, të cilin e përfaqëson av.B..... Q..... nga Ferizaj, kundër të paditurit B..... K..... nga Ferizaj rr. "E..... S....." nr.105, për çështjen juridike pengim posedim, duke vendosur sipas ankesës së paditësit të paraqitur kundër Aktvendimit të Gjykatës Themelore në Ferizaj C.2023:099537, të datës 03.08.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur me datën 16.05.2024, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

APROVOHET si e themeltë ankesa e paditësit A..... N.....nga fshati Elezaj rr. "Çamëria" Komuna Kaçanik, PRISHET Aktvendimit të Gjykatës Themelore në Ferizaj C.2023:099537, i datës 03.08.2023 dhe lënda i kthehet të njejtës në rigjykim dhe rivendosje.

**A r s y e t i m i**

Gjykata e shkallës së parë me Aktvendimin e atakuar C.2023:099537, të datës 03.08.2023, ka vendosur në këtë mënyrë: HUDHET POSHTË SI E PALEJUAR padia e paditësit A.....N..... nga fshati Elezaj Komuna Kaçanik, e ushtruar kundër të paditurit B..... K..... nga Ferizaj, për çështjen juridike pengim posedim.

Kundër këtij Aktvendimi, në afatin ligjor, paditësi përmes të autorizuarit të tij padituri ka paraqitur ankesë dhe atë për shkak të shkëljes së dispozitave të procedurës kontestimore, me propozim që ankesa të aprovohet, aktvendimi I atakuar të priset he lënda të kthehet në rigjykim dhe rivendosje.

Të paditurit nuk kanë paraqitur përgjigje në ankesë.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës dhe vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me pjesën e aktvendimit të ankimuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194 dhe 195, në lidhje me nenet 208 dhe 209 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

Ankesa e paditësit është e bazuar.

Në bazë të shkresave të lëndës shihet se paditësi me datë 02.05.2023 ka parashtruar padi ndaj të paditurve me këtë emërtim “për shkak të pengim posedimit të së drejtës së servitutit të kalimit”, ndërsa kërkesëpadija e saj është “*APROVOHET në tërësi si e batuar padia dhe kërkesëpadija e paditësit Avdi Neziri; DETYROHEN të paditurit B..... K..... dhe B..... K....., F..... N..... dhe H..... N.... që paditësit t'ia lejojnë kalimin nëpër pronat e tyre me qëllim paditësi të shfrytëzimit punoi tokat e tij; DETYROHEN të paditurit B..... K..... dhe B..... K....., F..... N..... që paditësit t'ia lejojnë kyqjen-lidhjen e sërishme të gypit të ujësjetës nga burimi i ujit deri në shtëpinë e tij; të gjitha këto në afat prej 15 dite nga nxjerrja e vendimit të gjykatës nën kërcënimin e ekzekutimit të dhunshëm; OBLIGOHEN të paditurit të paguajnë shpenzimet e procedurës gjyqësore*”.

Gjykata e shkallës së parë në seancën e datës 30.05.2023 përmes akvendimit ka detyruar paditësin që në afat prej 3 ditësh ta rregullon padinë në aspektin subjektiv dhe objektiv, ashtu që të përcaktoj qartë kërkesat kryesore dhe aksesore si dhe të rregulloj padinë me adresën e palës së paditur B..... K.....

Paditësi përmes parashtrësës së datës 02.06.2023 bënë rregullimin e padisë dhe kërkesëpadiës, ku petitumi i saj është “*APROVOHET në tërësi kërkesëpadija e paditësi A..... N..... nga fsh. Elezaj K. Kaçanik si e BAZUAR, dhe VËRTETOHEI që parcela e të paditurit me njësi kadastrale nr. 320-3 ZK B..... K. Ferizaj, është shfrytëzuar vazhdimisht që nga të parët e paditësit si paluajtshmëri shërbyese, për parcelën e paditësit me njësi kadastrale nr. 324-0 ZK B..... K. Ferizaj, në atë mënyrë që paluajtshmëria e shërbyese është shfrytëzuar nga paditësi për kalim deri në paluajtshmërinë dominuese dhe instalim të gypave të ujit me të cilët ishte sjellë uji nga parcela dominuese nëpër parcelën shërbyese e deri tek shtëpitë e paditësit e cila ndodhet në ngastrat kadastrale 374-0 dhe 381-0, nr. 324-0 B..... K. Ferizaj. ANDAJ, KRIJOHET Servituti Sendor mbi ngastrën e paditësit me njësi kadastrale nr. 3203 ZK B..... K. Ferizaj, e cila si paluajtshmëri shërbyese, do ti shërbej paluajtshmërisë dominuese të paditësit me njësi kadastrale nr. 324-0 ZK B.....K. Ferizaj, për kalim anasjellata dhe furnizim me ujë deri tek ngastrat kadastrale të paditësit me 374-0 dhe 381-0, nr. 324-0 ZK B..... K. Ferizaj. DETYROHET i padituri B..... K.....- nga Ferizaj, Rr."Ejup Statovci" nr.105 që paditësit, t'ia njoh të drejtat e përshkruara si në pikën II të dispozitivit këtij aktgjykimi, dhe të lejojnë të njëjtin që atë të drejtë ta regjistrojë në regjistrin e paluajtshmërive ZKK Ferizaj, në afat prej 15 dite pas pranimit të këtij aktgjykimi, në të kundërtën ky aktgjykim do ti shërbej paditësit për regjistrimin e servitutit sendor të përshkruar si në pikën II të dispozitivit këtij aktgjykimi, në regjistrin e paluajtshmërive ZKK Ferizaj, pa prezencën e të paditurit. DETYROHET i paditurit që paditësit, t'ia kompensojnë të gjitha shpenzimet e procedurës kontestimore në këtë çështje, dhe atë sipas rregullores tarifore të OAK-së respektivisht numrit tarifor 6 dhe 7 nga ekstrakti tabelar i asaj tarife të cilat shpenzime*

nga paditëset do të precizohen para fjalës përfundimtare, në afat prej 15 ditësh pas marrjes së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbartimit të detyrueshëm.

Gjykata e shkallës së parë pas pranimit të parashtrësës mbi rregullimin e padisë, nxjerrë Aktvendimin e atakuar, ku në arsyetimin e tij ndër të tjera thekson se lidhur me këtë çështje me datë 30.05.2023 ka caktuar seancën përgatitore të çështjes, ku me aktvendim procedural ka obliguar paditësin që të bëjë rregullimin e padisë në aspektin objektiv dhe subjektiv, ashtu që të përcaktoje saktë dhe qartë kërkesat kryesore dhe aksesore në këtë çështje si dhe të gjej adresën e palës së paditur B..... K..... në shtetin e Gjermanisë. Gjykata me datë 02.06.2023 ka pranuar parashtrësën nga i autorizuari i paditësit, për rregullimin e padisë në aspektin objektiv dhe subjektiv, në këtë parashtrësë paditësi ka bërë rregullimin e padisë në aspektin objektiv ashtu që me anë të padisë ka kërkuar krijimin e servitutit sendor në njësin kadastrale 320-3 dhe se e njëjta paluajtshmëri do të i shërbej paluajtshmërisë dominuese të paditësit 324-0 në ZK B..... si dhe sa i përket aspektit subjektiv si palët të paditur ka përfshirë B..... K.....nga Ferizaj. Gjykata vlerëson se i autorizuari i paditësit nuk ka vepruar konform udhëzimeve të dhëna në seancë përmes aktvendimi procedural për përmisim të padis në aspektin objektiv për të parashtruar qartë kërkesat kryesore dhe ato aksesore në raport me çështjen juridike pengim posedim, në mënyrë që të ipet vendim meritore, e në kontekst të kësaj gjykata ka analizuar edhe dispozitën e nenit 480 të LPK-së ku thuhet se; *''Shqyrtimi i çështjes sipas padisë për shkak të pengimit të posedimit do të kufizohet vetëm në konstatimin dhe të provuarit e fakteve të gjendjes së fundit të posedimit dhe të pengimit të bërë. Përjashtohet mundësia e shqyrtimit lidhur me të drejtën e posedimit, me bazën juridike, ndërgjegjshmërinë ose pandërgjegjshmërinë e posedimit. Përjashtohet mundësia që në kontestet për shkak të pengimit të posedimit të parashtrohet kërkesa për shpërblimin e dëmit të shkaktuar me anë të veprimeve me të cilat është bërë pengimi i posedimit.''*, bazuar në këtë dispozitë gjykata nuk mund të lëshohet në shqyrtimin e çështjes sipas precizimit të saj për krijimin e të drejtës së servitutit. Andaj, pretendimet e ngritura sipas precizimit të kërkesëpadisë së paditësit nga ana e paditësit në raport me të paditurin, mund të jenë objekt shqyrtimi në procedurë tjetër, e jo në kontestet e pengim posedimit dhe palët për mbrojtur/krijuar një të drejtë pronësore – sendore mund të iniciojnë procedurë të veçantë gjyqësore. Bazuar në të gjitha të lartcekurat, gjykata me këtë padi- precizim të kërkesëpadisë nuk mund të jep mbrojtje juridike paditësit në procedurën e inicuar sipas pengim posedimit, andaj nga të theksuarat më lartë gjykata konform nenit 480, 142, 253, 391 dhe lidhur me nenin 102 par.3 të LPK-së, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij Aktvendimi.

Gjykata e Apelit e Kosovës, nisur nga kjo gjendje e kësaj çështje, vlerëson së përfundimi dhe qëndrimi i gjykatës shkallës së parë rreth mënyrës së vendosjes, nuk është i drejtë dhe i ligjshëm, ngase aktvendimi i atakuar është marrë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182.1 dhe 182.2 pika i) të LPK, pasi që paditësit nuk i është dhënë mundësia e shqyrtimit të rastit të tij në mënyrë meritore, përkatësisht çështja e tij nuk është zgjidhur në themel, se është e bazuar apo jo kërkesëpadija e tij. Gjykata e Apelit vlerëson se paditësi përveç se përcakton palën e paditur në një process gjyqësor, po ashtu ai e përcakton edhe kërkesën e natyrës procedural-juridike për dhënien e mbrojtjes juridike të përmbajtjes së caktuar. Në shkresat e lëndës vërtetohet se paditësi edhe me padinë fillestare të datës

02.05.2023 dhe me atë të precizuar përmes parashtrës së datës 02.06.2023, kërkon mbrojtje gjyqësore, përkatësisht krijimin e servitutit sendor, i cili institut gjyqësor dallon nga kontesti i pengim posedimit që në fakt paditësi nuk kërkon mbrojtje gjyqësore për shkak të pengim posedimit, bazuar në padinë fillestare të paditësit dhe atë të precizuar.

Me rastin e shqyrtimit të aktvendimit të atakuar, brenda kufijve të pretendimeve ankimore, si dhe sipas detyrës zyrtare (ex officio), në kuptim të nenit 194 të LPK-së, Gjykatës së Apelit i rezulton se dispozitivi dhe arsyetimi i aktvendimit të shkallës së parë nuk është formuluar konform nenit 160 të LPK-së, që përcakton strukturën dhe përmbajtjen që duhet ta ketë një vendim gjyqësor për të qenë i drejtë dhe i ligjshëm.

Gjykata e Apelit vlerëson se gjykata e shkallës së parë ka bërë shkelje të nenit 182.1 dhe 2 të LPK-ës, për arsye ka vendosur për një kërkesë për pengim posedim, që në fakt paditësi nuk e ka parashtruar. Pala ka në dispozicion jo vetëm mundësinë për fillimin e një procesi gjyqësor civil, por edhe që vetë të vendosin se për çka do të procedohet në një proces gjyqësor civil, që në rastin konkret është krijimi i servitutit sendore e jo pengim posedimi, të cilën kërkesë gjykata e shkallës së parë e ka hedhur poshtë si të palejuar. Lidhur me kërkesëpadinë e paditësit është e lidhur gjykata, pra për te duhet të vendos, pra gjykata nuk mund të vendos për diçka që nuk ka kërkuar pala.

Kjo Gjykatë se pari vëren se praktika gjyqësore e GJEDNJ-së vazhdimisht konsideron se drejtësia e procedurës vlerësohet në bazë të procedurës si tërësi (shih Aktgjykimi i GJEDNJ-së, Barbera, Messeque dhe Jabardo kunder Spanjes, nr. 146, paragrafi 68). Prandaj, në procedurën e vlerësimit të bazës së pretendimeve të paditësit, gjykata e shkallës së parë do t'u permbahet këtyre parimeve, përkatësisht kërkesës së palës, ashtu siç parashihet në dispozitën e nenit 2.1 të LPK-ës, I cili përcakton se "*Në procedurë kontestimore gjykata vendos brenda kufijve të kërkesave që janë parashtruar nga palët ndërgjyqëse*". Gjykata e Apelit rikujton se në rastin Golder kundër Mbretërisë së Bashkuar, në paragrafin 36, GJEDNJ-ja konstatoi: "36. (...) e drejta e qasjes përbën një element që është i pandarë në të drejtën e përcaktuar në nenin 6 paragrafi. 1. Neni 6 para. 1 u siguron të gjithëve të drejtën për të iniciuar procedurë për përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve të tij civile pranë një gjykate ose tribunali. Në këtë mënyrë, ky nen përfshin "të drejtën për një gjykatë", nga e cila e drejta e qasjes, përkatësisht e drejta për të filluar procedura pranë gjykatave në çështjet civile, përbën vetëm një aspekt. (shih rastin Golder kundër Mbretërisë së Bashkuar, 21 shkurt 1975, 28-36, Seria A. nr. 18). Ndërsa në mënyrë që e drejta e qasjes të jetë efektive, atëherë paditësi duhet të ketë mundësinë e shqyrtimit të kërkesëpadisë së tij konform dispozitave të LPK-ës, dhe të drejtës pozitive në Republikën e Kosovës. Prandaj, në pajtim me praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, e drejta e qasjes në gjykatë nuk nënkupton vetëm të drejtën për të filluar procedurat pranë një gjykate, por, me qëllim që e drejta e qasjes në gjykatë të jetë efektive, individi, në këtë rast paditësi duhet të ketë gjithashtu një mundësi të qartë dhe reale për ta shqyrtuar në merita çështjen e tij. Me fjalë të tjera, e drejta e qasjes në gjykatë nuk shterohet vetëm në të drejtën për të filluar procedurën civile në gjykatë, por kuptimi i saj është shumë më i gjëë pasi që përfshin të drejtën për "zgjidhjen" e mosmarrëveshjes nga gjykata kompetente.

Gjykata e Apelit vlerëson se gjykata e shkallës së parë mund të vendos në mënyrë procedurale ta zgjidhë një çështje të caktuar (jo në merita), vetëm atëherë kur plotësohet në mënyrë të qartë kushtet ligjore të përcaktuara në dispozitat e LPK-ës (psh. 409, 423.3, 391 etj).

Nga gjitha arsyet e cekuara si më lartë, Gjykata e Apelit gjeti se aktvendimi i atakuar është përfshirë në shkeljet e sipërcituara të cilat gjykata e shkallës së parë duhet t'i eliminojë në ri procedurë, në atë mënyrë që të ndërmerr veprime përmes të cilave do t'i eliminoj shkeljet e cekura si më lartë, por njëkohësisht duke u kujdesur edhe për çështjet e tjera nga të cilat varet lejueshmëria e procesit gjyqësor dhe në këtë kuptim duhet të vlerësoj të gjitha prezumimet procedurale që kanë të bëjnë me gjykatën, palët-përfaqësimin, objektin e kontestit dhe rregullsitë formale të padisë dhe të vendos për themelësinë e kërkesëpadisë së paditësit. Me rastin e vendosjes në lidhje me kërkesëpadinë e paditësit, gjykata e shkallës së parë, përveçse ka për detyrim që të vërtetoj drejtë dhe në mënyrë të plotë gjendjen faktike në këtë procedurë, ajo duhet të kujdeset për zbatimin e drejtë të së drejtës materiale. Andaj, udhëzohet gjykata e shkallës së parë që në ri procedurë të veprojë sipas vërejtjeve të gjykatës së shkallës së dytë, t'i eliminojë shkeljet e sipër theksuara, pas administrimit të provave të propozuara nga palët ndërgjyqëse të zbatojë me përpikëri nenin 8, lidhur me nenin 160 parag.4 të LPK-së, përkatësisht në arsyetimin e aktvendimit të jap të gjitha vlerësimet e nevojshme për secilën provë të administruar, cilat fakte vendimtare i ka vërtetuar me provat e administruara dhe pas vërtetimit të gjendjes faktike, të vendos për kërkesëpadinë e paditësit në bazë të ligjit, përfshirë këtu edhe për shpenzimet e procedurës kontestimore.

Nga të cekurat më lartë, e në mbështetje të dispozitave nga nenet 194, 195 dhe neneve 208 dhe 209 par. 1 pika (d), të LPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

## GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË

Ac.nr.7439/2023, datë 16.05.2024

Kryetari i kolegjit,

Ardian Ajvazi